

Qendra e Krizave - ju nevojitet ndihma jonë?

Nuk jeni të sigurt në shtëpinë tuaj?

Fatkeqësisht ka shumë gra, burra dhe fëmijë që përjetojnë keqtrajtim dhe dhunim në shtëpitë e tyre. Në Norvegji ne e quajmë këtë 'dhunë brenda marrëdhënieve të ngushta'. Kjo do të thotë se ekziston dikush që është i afërt me ju, për shembull bashkëshorti, prindi, motra apo vëllai, ose fëmija juaj që ushtron ndaj teje dhunë/dhunim.

Ka shumë lloje të keqtrajtimeve/dhunës:

- **Fizike** (goditje, shkelmim, tërheqje nga flokët, shtrëngim)
- **Psikologjike** (thënia e fjalëve të pakëndshme, thërritja e emrave të pakëndshëm, kontroll, izolim, kërcënim)
- **Seksuale** (përdhunim, marrëdhënie seksuale të detyruara)
- **Materiale** (flakja e sendeve, thyerrja e sendeve, dëmtimi i diçkaje që ka shumë domethënie për ty)
- **Financiare** (marrja e parave të tua, mosdhënia e parave të tua, të detyruarit për të firmosur dokumente financiare, të cilat nuk i kupton)
- **Martesa e detyruar** (kërcënim/detyrimi për t'u martuar pa dëshirë)
- **Gjymtim gjeneral** (dërja syne e organit gjeneral femëror)
- **Trafikim njerëzor** (shitblerja e grave, burrave dhe fëmijëve)

A keni nevojë për dikë me të cilin të flisni?

Kontakttoni një qendër krizash pranë jush. Në Norvegji, të gjitha gratë, burrat dhe fëmijët kanë të drejtën të marrin ndihmë nga qendrat e krizave kur ata kërcënohen apo janë të ekspozuar ndaj dhunës.

Je i ri në Norvegji?

Ne që punojmë në qendrat e krizave, takojmë shumë

njerëz nga vendet dhe nga kulturat e tjera. **Ne përdorim gjithmonë një përkthyes kur është e nevojshme.** Punonjësit tanë janë profesionalisht të trajnuar dhe kanë aftësi të veçanta që të ndihmojnë ata që janë të ekspozuar ndaj dhunës. Ata do t'ju informojnë për të drejtat tuaja, detyrimet dhe mundësitë në Norvegji.

Ne jemi betuar për sekret profesional! Historia juaj është e sigurt te ne. Ne nuk do të zbulojmë asgjë që na thoni, përveç nëse kemi rënë dakord për këtë dhe si pjesë për të ecur përpara dhe për të ju ndihmuar që të merrni ndihmën që keni nevojë.

Megjithatë, ne jemi të obliguar të raportojmë te shërbimet e kujdesit të fëmijës nëse mësojmë për fëmijë me gjendje të papranueshme në shtëpi. Në mënyrë që fëmijët dhe familjet të marrin ndihmën që u nevojitet për të bërë një jetë të mirë.

Ne mund t'ju ndihmojmë me këto që vijojnë:

Mund t'ju sigurojmë juve dhe fëmijëve tuaj një vend të sigurt për të jetuar për një periudhë kohe ose ju mund të zgjidhni të jetoni në shtëpi dhe të vini në qendrën e krizave vetëm për të folur për situatën tuaj. Në qendrën e krizave do të takoni një profesionist që do të dëgjojë atë që thoni. Ne mund t'ju ndihmojmë të kontaktoni një doktor, avokat, Policinë, NAV-in, shërbimet e kujdesit të fëmijëve apo agjenci të tjera. Ne do t'ju mbështesim ju dhe do të vijmë me ju në takime nëse ju do të dëshironit dhe nëse situata e sigurisë e mundëson këtë. Mund të vazhdojmë të mbetemi në kontakt pasi të keni dalë nga qendra e krizave, nëse keni nevojë për këtë.

Roli ynë është t'ju sigurojmë informacionin, mbështetjen dhe udhëzimin që ju nevojitet për t'ju ndihmuar në rrugën tuaj për një jetë më të mirë e pa dhunë.